



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 2, Datë 5.04.2017

Për

**Miratimin në lidhje me projektin “Mbilartësimi i portave të digës dhe rikonstruksioni i paisjeve të Hidrocentralit Ulzë”.**

Në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, nenit 8 nenit 9 si dhe pika 4 e nenit 20 të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e tij të datës 04.04.2017, mori në shqyrtim materialin e arrdhur nga kompania “Kurum Internacional” sh.a në lidhje me “Mbilartësimin e portave të digës dhe rikonstruksionin e paisjeve të Hidrocentralit Ulzë”. Materiali u prezantua nga përfaqësuesit e Shoqërisë “Kurum Internacional” sh.a. Reçenca është hartuar nga firma “ELBA” shpk.

Pas prezantimit analizës dhe diskutimeve të anëtarëve, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha :

VENDOSI

Të miratojë projektin në lidhje me “Mbilartësimin e portave të digës dhe rikonstruksionin e paisjeve të Hidrocentralit Ulzë” duke plotësuar sa më poshtë :

1. Të bëhet mikrozonimi sizmik për saktësimin e të dhënave.

2. Me qëllim të saktësimit të të dhënave hidrometeorologjike, të vazhdojnë matjet e prurjeve në lumin Mat, të shoqërohen me matjet e rreshjeve përkatëse dhe nga autorët e projektit në bashkëpunim dhe me IGJEUM-in, të rillogariten plotat dhe prurjet respektive të shkarkimit. Kjo llogaritje të bëhet duke marrë në konsideratë të dhënat deri në fund të prillit 2018. Llogaritjet të paraqiten për shqyrtim e miratim në KKDM nga do jepen dhe sugjerimet përkatëse.
3. Të bëhet rregullorja e shfrytëzimit dhe përpunimit të plotave për shkarkimet maximale, nga shoqëria “Kurum” në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Brëndëshme.
4. Me rritjen e nivelit të ujit të rritet frekuenca e matjeve të filtrimeve në trupin e digës si dhe aparaturave të tjera në digë.
5. Të hartohet “Plani i alarmit dhe evakuimit të popullatës” për shkarkimet maksimale dhe verifikimi i tij, në zbatim të Udhëzimit nr.248, datë 28.01.2000.
6. Materialet e studimit sizmik dhe studimi i ri hidrologjik e hidrometeorologjik të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi të paraqiten për miratim në KKDM, brënda datës 30 Qershor 2018.

Inxh.Maksim Muçi

K R Y E T A R

